

Nr. 1730 Prot.
Tiranë, më 30.12 2022

Nr. 2912 Prot.
Tiranë, më 23.12 2022

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur sot me date **22/12/2022** në Spitalin Universitar të Traumës, midis palëve si me poshte:

- **Spitali Universitar i Traumës**, Institucion publik, me NIPT L31322455E dhe seli në adresën: Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë, E-mail: spitalitraumes@shendetesia.gov.al; përfaqësuar ligjërisht nga **Drejtoresha Znj. Edlira BODE**, me poshtë referuar si "SUT",

Dhe

- **Universiteti "BARLETI"** person juridik i së drejtës shqipëtare regjistruar më datë 03.12.2004, licensuar me NIPT K52115006H, me adresë: Rr. Frang BARDHI, Nr.118, Selite, Tiranë, përfaqësuar për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nga Rektori i Universitetit "BARLETI" **Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI** më poshtë referuar "Universiteti";

Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 7850 date 29/07/1994 "*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*" të ndryshuar dhe Ligin nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH*"

Palët bien dakord për sa më poshtë:

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka si qëllim ofrimin e shërbimeve të ndërmjetëm me interes të përbashket dhe lehtësimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet palëve.
2. SUT merr përsipër mundësimin e zhvillimit të praktikave profesionale dhe mësimore në fushën e Mjekësisë për studentët e Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit "BARLETI".
3. SUT në bashkëpunim me Universitetin dhe kur dakortësohet mes palëve; zotohen në organizimin dhe bashkëpunimin në trajnime, studime kërkimore - shkencore, konferenca të përbashkëta në fushën e Shkencave Mjekësore Teknike.
4. SUT në çdo fillim viti akademik, por jo me vonë se data 30 Nëntor, duhet të informohet nga Universiteti zyrtarisht (elektronikisht apo me shkresë) për numrin e studentëve të Shkencave Mjekësore Teknike të cilët do të kenë të drejtë akses në ambientet e SUT me qëllim përmbushjen e funksioneve kërkimore shkencore, funksioneve akademike teorike dhe praktike përgjatë vitit akademik.
5. Studentët e Shkencave Mjekësore Teknike do të angazhohen në ndjekjen e programit të praktikës profesionale duke përdorur ambientet dhe pajisjet e SUT, nën mbikqyrjen e tutorit, personeli SUT dhe i cili do të përcaktohet nga Universiteti.


6. SUT duhet te japë miratimin për numrin e studentëve ose të propozojë një numër të përshtatshëm në përputhje me ngarkesën e punës në spital.
7. SUT gëzon të drejtën për të pezulluar praktikat studentore në situatë jo të zakonshme (emergjenca civile, forcë madhore, etj.) duke bërë me dije universitetin mbi argumentat përkatëse.
8. Universiteti mban përgjegjësi për dëmet e çfarëdo lloj natyre, (dëm pasuror, dëm jo pasuror, dëm biologjik, dëm moral, dëm ekzistencial etj) të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të shkaktuar nga ana e studenteve gjatë praktikës mësimore.
9. Studentët kryejnë çdo aktivitetet në zbatim të rregullave të brendshme të SUT.
10. Studentët duhet të jenë të pajisur me uniformë dhe mjet identifikimi ("badge") nga Universiteti "BARLETI" element identifikues me të cilat SUT do të njihet para nisjes së praktikës.

Të tjera

1. Ky Memorandum hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.
2. Ndryshimet në këtë Memorandum do të bëhen vetem pasi të jenë miratuar me shkrim nga Palët.
3. Ky memorandum ka vlefshmeri 3 vjeçare nga data e firmosjes, me të drejtë rinovimi dhe zgjidhje me shprehjen me shkrim/e-mail të palëve.
4. Mosmarrëveshjet midis Palëve për këtë Memorandum, do të zgjidhen me negociim në të kundërt do të quhet Memorandum i përfunduar dhe i zgjidhur.

UNIVERSITETI "BARLETI"

REKTORI
Prof. Dr. SUZANA GUXHOLLI



SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

DREJTORE
EDLIRA BODE

